



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

PROGRAMI: INFORMATIKË BIZNESI (MSc.)

Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit:	Informatikë Biznesi
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i dytë i Bolonjës (Master) MSc., Niveli i VII
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Mastre i Shkencës në Informatikë Biznesi (MSc.)
Fusha e studimit sipas <i>Erasmus Subject Area Codes</i> (ESAC):	04.2
Kohëzgjatja minimale e studimit:	2 vite, 4 semestra
Forma e studimit:	Studime të rregullta
Numri i ECTS kredive:	Gjithsej 120 ECTS, për një vit 60 ECTS
Profili i programit akademik (specializimi):	1. Informatikë
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi i studimeve Master i shkencës në Informatikë biznesi është një kurrikulë e studimeve të avancuara që ofron arsimim profesional – shkencor në këtë fushë të rëndësishme të studimit. Është një model studimor i nivelit të lartë i projektuar për të siguruar njohuri të plotë në Informatikë biznesi. Programi u ofron studentëve një studim të nivelit hulumtues në lëmin e Informatikës së biznesit që është një nga fushat kryesore nga e cila sot varet veprimtaria e ndërmarrjeve për rritjen e efektivitetit dhe arrizmit të tyre. Programi Master në Informatikë biznesi ka për objektiv t'i përgjigjet nevojës për personel të kualifikuar, duke pëmbushur nevojat e tregut të punës me profesionist në sferën e informatikës dhe biznesit. Studentët pritet të tregojnë origjinalitet në zbatimin e njohurive të fituara nga fusha e Informatikës dhe

	biznesit, dhe të kuptojnë se si njohuritë e tyre janë duke u avancuar përmes hulumtimit akade Demonstron njohuritë e zhvilluara dhe mendimin kritik mbi konceptet kryesore, metodologjitë, përparimet aktuale teknologjike dhe qasjet teorike interdisiplinare në fushën e Informatikës së aplikuar në segmente të ndryshme të biznesit. Ata do të jenë në gjendje të merren me çështje komplekse në mënyrë sistematike dhe kreative, dhe do të tregojnë kapacitet të pavarur në adresimin e çështjeve dhe problemeve në fushën e caktuar. Programi në përgjithësi kombinon teorinë, metodat dhe teknikat nga biznesi dhe shkenca menaxheriale me mjetet dhe praktikatat e informacionit dhe shkencës informatike.
Rezultatet e pritshme të të nxënës:	- Demonstron njohuri të zhvilluara dhe të menduarit kritik mbi konceptet kryesore, metodologjitë, përparimet aktuale teknologjike dhe qasjet teorike ndërdisiplinore në fushën e Informatikës të aplikuar në segmente të ndryshme të biznesit; - Zbaton njohuritë teorike dhe praktike mbi transformimin dhe digjitalizimin e biznesit, zhvillimin e modeleve të reja të biznesit dhe përdorimin e përparuar të teknologjisë së informacionit në operacionet e biznesit; - Zbaton njohuritë e nevojshme në fushat e zhvillimit dhe prezantimit të sistemeve të informacionit; - Zbaton aftësitë e zhvilluara mbi mbledhjen, rishikimin, vlerësimin dhe interpretimin e informacionit; - Analizon planifikimin strategjik të biznesit digjital, informatikës, infrastrukturës së informacionit, arkitekturës si dhe sistemet e integritetit në organizata; - Demonstron njohuritë e fituara mbi modelimin, hartimin dhe zgjidhjen e softuerëve të cilët sigurojnë rritjen e cilësisë së informacionit në organizatë; - Zbaton përvojën e fituar teorike dhe praktike në funksion të udhëheqjes së një departamenti për informatikë, procese biznesi ose biznes digjital; - Demonstron aftësitë profesionale dhe kërkimore për të vazhduar studimet akademike apo shkencore të disiplinës së informatikës së biznesit në nivel më të lartë të shkollimit.
Procedurat e mësimdhënies:	- Procesi mësimor mbahet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve dhe ushtrimeve laboratike. Pothuajse të gjitha lëndët përmbajnë dhe punën kërkimore dhe dy teste gjatë kursit semestral. - Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 50 : 50. Në disa raste, sipas natyrës së lëndës dhe e paraparë me syllabus ky raport mund të jetë 60:40. - Gjithashtu studentet kanë hapësirë që të shprehin njohuritë

	e përgjithshme në praktikë në kuadër të lëndës “Praktika dhe Zhvillimi i Karrierës”. Kjo lëndë është obligative dhe gjatë semestrit studentet janë të obliguar që të përfundojnë praktikën në institucione publike ose private. Aktiviteti rreth sigurimit të punës praktike për studentë dhe organizimi i punës për këtë çështje bëhet nga ana e Qendrës për Zhvillimin e Karrierës, UHZ. Mësimdhënia organizohet në bazë të kësaj metodologjie: - Ligjërata inter-aktive dhe prezantime në “Power Point” ose “Prezzi”; - Analiza të rasteve të studimit dhe shembuj nga praktika e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare; - Diskutime dhe komunikim i hapur pedagog – student; - Ushtrime me shembuj konkretë nga fusha të ndryshme të aplikimit të informatikës; - Detyra që prezantohen dhe diskutohen nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor nën frymën e një bashkëveprimi produktiv dhe nën kushtet e një ambienti të favorshëm mësimi;
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë. Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve seminareve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. Metodat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, Një shembull vlerësimi është si më poshtë: Pjesëmarrja aktive në mësim.....10% Detyrat, ushtrimet.....10% Testi i parë.....20% Testi i dytë.....20% Provimi përfundimtar.....40% Total 100% Gjersa, një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: 0-50.99%(5) 51-60.99%(6) 61-70.99%(7) 71-80.99%(8) 81-90.99%(9)

	91-100%(10)
Modulet /Lëndët (titujt):	1. Metodatat cilësore në kërkim shkencor 2. Metodatat dhe teknikat sasore në kërkim shkencor 3. Mësimi praktik dhe Internship 4. Tregtia elektronike 5. Menaxhimi i dijes 6. Menaxhimi i proceseve në biznes 7. Sisteme informacioni të financave dhe kontabilitetit 8. Menaxhimi i riskut kibernetik 9. Big Data 10. Cloud Computing 11. Sisteme informacioni dhe komunikimi në biznes 12. Menaxhimi i projekteve të IT 13. Sisteme të menaxhimit të bazave të dhënave 14. Sisteme interaktive kompjuterike 15. Web dizajn për biznes 16. Menaxhimi i riskut kibernetik 17. Punimi i diplomës Master 18. Marketingu digjital 19. Menaxhimi i dijes me elementet e AI 20. Financat digjitale 21. Inteligjenca biznesore 22. Ndërmarrësia dhe inovacionet 23. Menaxhimi i zingjirit të furnizimit 24. Organizimi dhe Menaxhmenti
Numri i vendeve të studimit:	60 në gjuhë shqipe
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	1. Prof. Dr. Edmond Beqiri
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	2 profesorë të rregulltë, 3 profesorë të asocuar, 4 profesorë asistent dhe 2 asistentë.
Taksat e studimit:	Të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Studimet janë falas. Vërejtje: Në rast kur përsëritet viti, bëhet pagesa sipas Udhëzimit Administrativ MASHTI Nr.09/2021.
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	1. Ndërmarrje të teknologjisë informative (IT Companies) • Ndërmarrje për zhvillim dhe mirëmbajtje softueri • Ndërmarrje për testim dhe sigurim të cilësisë së softuerit (Software Testing / QA) • Kompani për analizë të sistemeve informative dhe biznesit

- Ndërmarrje për **zhvillim aplikacionesh web dhe mobile**
- Kompani për **menaxhim të sistemeve cloud dhe databazave**
- Ndërmarrje për **siguri kibernetike dhe menaxhim të riskut IT**

2. Ndërmarrje të analizës së të dhënave dhe inteligjencës biznesore

- Kompani për **Big Data dhe Data Analytics**
- Ndërmarrje për **Business Intelligence (BI) dhe raportim menaxherial**
- Kompani për **analizë performance dhe vendimmarrje strategjike**
- Ofrues shërbimesh për **AI dhe menaxhim të dijes**

3. Ndërmarrje financiare dhe kontabël

- Banka dhe institucione mikrofinanciare
- Kompani për **FinTech dhe pagesa digjitale**
- Zyra kontabiliteti dhe auditimi
- Ndërmarrje për **sisteme financiare dhe ERP**
- Kompani sigurimesh dhe menaxhim risku

4. Ndërmarrje tregtare dhe të shërbimeve

- Ndërmarrje të **tregtisë elektronike (e-commerce)**
- Kompani të marketingut digjital dhe reklamimit online
- Ndërmarrje të logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit
- Kompani të shitjes dhe menaxhimit të marrëdhënieve me klientë (CRM)

5. Ndërmarrje konsulence dhe shërbimesh profesionale

- Kompani për **konsulencë biznesi dhe IT**
- Ndërmarrje për **menaxhim projekteve dhe procese biznesi**
- Kompani për **transformim digjital**
- Kompani për **optimizim kostosh dhe performance**

6. Ndërmarrje prodhuese dhe industriale

- Ndërmarrje prodhuese që përdorin **sisteme informative dhe ERP**
- Kompani industriale me **automatizim dhe sisteme digjitale**

- Ndërmarrje për **menaxhim të të dhënave operative**

7. Start-up dhe ndërmarrje inovative

- Start-up teknologjike dhe digjitale
- Ndërmarrje për **produkte dhe shërbime softuerike**
- Inkubatorë biznesi dhe qendra inovacioni
- Platforma digjitale dhe shërbime online

8. Institucione publike dhe organizata ndërkombëtare

- Institucione publike me sisteme informative
- Agjenci zhvillimore dhe projekte digjitale
- Organizata ndërkombëtare dhe OJQ
- Institucione për **qeverisje elektronike (e-Government)**

9. Vetëpunësim për shërbime të IT